

VENDIM
Nr.1115, datë 13.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN
E EKONOMISË DHE ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR
MOISIU”, DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË
TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010, NË KËTË
PROGRAM STUDIUM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në fakultetin e ekonomisë dhe administrimit, të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në “Shkencat ekonomike”.

2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në shkencat ekonomike”.

3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 30, nga e cila dy kuota caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha